


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NOTERE Neriman MARIKA
Nr. 2393 Rep.
Nr. 279/3 Kol.



KONTRATË SHIT - BLERJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 28. Dhjetor 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), përpara meje Noteres **Neriman MARIKA**, anëtare pranë Dhomës së Noterëve Tiranë me seli në adresën Autostrada Tiranë Durrës, km 10, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme

SHITËSI:

- **MARKETING & DISTRIBUTION SH.P.K**, person juridik shqiptar, identifikuar me numër NIPT J72124001N, me seli në adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Rruga dytësore, Km 10, Kashar, Tiranë, përfaqësuar nga ana e Administratorit të shoqërisë **Z. Sokol VEHLI**, shtetas shqiptar, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, shtetas shqiptar, i datëlindjes 13./...9.../1955, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë në Rr. Ymer Kurti, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër 021965250 e nr. Personal F.50.9.1.3.1.16 C

DHE

BLERESI:

- **MARKETING & DISTRIBUTION LTD KOSOVË** e regjistruar me NIPT 80667051 me adresë rruga Zona Industriale, Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Administratori **Z. Ermal RAMOSACO**, në cilësinë e Përfaqësuesit Ligjorë të shoqërisë, shtetas shqiptar, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, shtetas shqiptar, i datëlindjes 19./...11.../1979, lindur në Tirane dhe banues në Kosovë në Prishtinë, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër 029442576 nr. Personal H.711190.38 P

Palët kane rënë dakort për lidhjen e kësaj kontrate per shit-blerjen e kuotave, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME:

Shitësi në këtë kontratë është ortak i shoqërisë Pri-Invest sh.p.k (këtu e më poshtë do të përmenden me emrin Shoqëria), një shoqëri e krijuar sipas ligjeve shqiptare, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, identifikuar me NIPT L81423026D. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në fushën e administrimit, të blerjes, të shitjes, ndërmjetesimit dhe tregtimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shitësi është zoterues i padiskutueshëm dhe pronarë i 99.32 % të kapitalit të Shoqërisë Pri-Invest

Sh.p.k.

Blerësi, **Marketing Distribution Sh.p.k Kosovë** është aktualisht zotëues i 0.68 % të kapitalit të shoqërisë Pri-Invest Sh.p.k, pas ndjekjes së procedurave të fitimit të pronësisë të kapitalit të Shoqërisë dhe eventualisht do bëhet ortak ne masen 100 % të kapitalit të Shoqërisë PRI-INVEST sh.p.k me të gjithë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia e kuotave të përmendura.

NENI 1 PËRKUFIZIMET

Termet e mëposhtme do të kenë kuptimet e tyre përkatëse sic janë përdorur në këtë kontratë :

Kontrate do të kuptojmë këtë Kontratë për shitjen dhe blerjen e kuotave, të arritur midis Shitesit dhe Blerësit.

Transferim do të kuptojmë shitjen dhe blerjen e kuotave, dhe në përgjithësi pranimin, nënshkrimin dhe dorëzimin e të gjithë dokumentacionit dhe përmbushjen e të gjithë detyrimeve ashtu siç kërkohej për transferimin në përputhje me këtë kontratë.

Date Transferimi do të kuptojmë datën e nënshkrimit të kësaj kontratë nga të dyja palët në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Pale do të kuptojmë Shitesin dhe Blerësit, ose të dy, ashtu si përcaktohet nga përmbajtja e kontratës;

Shoqëri do të kuptojmë Pri-Invest Sh.p.k.

Cmim transferimi do të kuptojmë cmimin e plotë që Blerësi do të paguajë Shitesit për shitjen e kuotave, siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj kontratë;

Transferim kuote do të kuptojmë 99.32 % të kapitalit të Shoqërisë.

Bilanc Transferimi do të kuptojmë bilancin e shoqërisë, miratuar rregullisht nga organet kompetente të shoqërisë dhe e cila është pranuar nga palët si pjesë integrale e kontratës,


Vendim i Ortakeve do të kuptojmë Vendimin e Pri-Invest sh.p.k për miratimin e transferimit të masës prej 99.32 % të kapitalit dhe / ose Vendimin e Blerësit për miratimin e blerjes të kuotave në masën 99.32% të kapitalit të shoqërisë.

Detyrime të Shoqërisë do të kenë kuptimin e ndonjë detyrimi financiar, apo tatimi ose detyrimi tjetër të PRI-INVEST shpk kundrejt çdo lloq entit privat apo publik.

Fjalet e përdorura në një prej këtyre kontratave do të përfshijnë edhe shumësin e tyre.

NENI 2 OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontratë është transferimi i 99.32% të kapitalit të shoqërisë Pri-Invest shpk nga shitësi tek blerësi, nënshkruar dhe dorëzuar në mënyrë të vlefshme, duke përfaqësuar kontributin në të holla të ortakëve, i cili është shitësi në këtë kontratë.



NENI 3
CMIMI I TRANSFERIMIT TË KUOTAVE DHE PAGESA

Bleresi ne menyre te parevokueshme bie dakord qe vlera shitjes eshte **151,691,870 (njëqind e pesëdhjetë e një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) Lekë e cila perfaqeson çmimin e transferimit te masës prej 99.32% të kapitalit të shoqërisë.**

Duke qënë se Marketing & Distribution sh.p.k Kosovë ka kryer një financim ndaj shoqërisë **Shitëse Marketing & Distribution sh.p.k ku burim financimi ka qënë financimi i Ortakut të Vetëm të shoqërisë Marketing & Distribution Sh.p.k Kosove dhe Marketing & Distribution Shqiperi, palët bien dakord që vlera e shitblerjes sipas kësaj kontrate do të likujdohet nëpërmjet kompensimit mes vlerës së kontratës dhe vlerës së kthimit të financimit.**

Palet deklaruan se nuk do te kene tani dhe ne te ardhmen asnje pretendim per cmimin e transferimit.

NENI 4
TRANSFERIMI I PRONËSISË



Bleresi, pas nenshkrimit te kesaj kontrate dhe miratimin e transferimit te **99.32%** kuotave te kapitalit nga Shitesi, do te behet Ortak në masën 100 % te kapitalit total te shoqerise Pri-Invest Sh.p.k.

Dokumentacioni për transferimit te kuotës depozitohet në Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 5
DETYRIMET E PALËVE

Duke mos perjashtuar ndonje veprim tjeter qe duhet te ndermerret apo te ndonje instrument qe duhet te nenshkruhet dhe ose qe duhet te dorezohet ne perputhje me kete kontrate per transferimin e kuotave


a) Shitesi duhet:

- 1- Te dorezoje Vendimin e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise per miratimin e operacionit te shitjes dhe blerjes se kuotave.
- 2- Te nenshkruaje ose te dorezoje ose duhet te beje te mundur nenshkrimin ose dorezimin e dokumentave te tjere te nevojshem ne perputhje me legjislacion shqiptar dhe qe lejon tranferimin pronesise ne masen 99.32% te kapitalit te shoqerise ne favor te Bleresit.

Dhe

b) Bleresi duhet:

- 1- Te paguaje cmimin e plote te shitjes se 99.32% te kapitalit te shoqerise ne shumen e percaktuar ne nenin 3 te kesaj kontrate dhe ne menyren e pershkruara ne kontrate.
- 2- Te dorezoje Vendimin e Shoqerise per miratimin e blerjes se 99.32% te kapitalit te shoqerise dhe per caktimin e perfaqesuesve gjate procedurave te lidhjes dhe noterizimit te kontrates, ne perputhje me kerkesat e percaktuara nga legjislacioni shqiptar.



Me realizimin e shitjes se 99.32% te kapitalit te shoqerise nga shitesi, Bleresi do te fitoje pronesine e kesaj mase te kapitalit te shoqerise ne daten e transferimit dhe do te fitoje ndonje dividend te deklaruar dhe te paguar si gjithë detyrimet dhe te drejtat qe rrjedhin nga pronesia e kuotave.

Shoqeria, pas shitjes se kuotave ne favor te Bleresit, do te procedoje me depozitim e praktikes perkatese te shit-blerjes se kuotave ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

NENI 6 DEKLARIMET DHE GARANCITË E PALËVE

Shitesi deklaron dhe garanton Bleresit sa me poshte;

- a. Shitesi eshte ortak i vetëm i 99.32% të kapitalit të Shoqërise. Shitesi ka ndermarre te gjitha veprimet e nevojshme per te lejuar zbatimin dhe ekzekutimin e kesaj kontrate. Kjo kontrate eshte e vlefshme dhe detyruese per Shitesin ne perputhje me termat dhe kushtet e percaktuara ne te.
- b. Shoqeria Pri-Invest sh.p.k shpk ka autoritet te plote dhe kompetence per te vepruar ne perputhje me objektin e aktivitetit te saj dhe per te zoteruar pasurite dhe aktivitet ne pronesine e saj. Shoqeria eshte e kualifikuar dhe e licencuar sipas ligjeve per te ushtruar aktivitetin e saj. Shitesi garanton te mos ndryshoje ose te mos shfuqizojë dokumentat ligjore te shoqerise qe kane te bejne me aktin e themelimit te saj dhe me licensat per aktivitete e lejuara, deri ne daten e transferimit.
- c. Zbatimi i kesaj kontrate nuk dhunon ose perben shkelje te ndonje dispozite apo akti te Shoqerise.

Shoqeria nuk konsiderohet e paaftë per te permbushur dhe ekzekutuar ndonje detyrim, mjet kontraktor apo marreveshje ku ajo eshte pale ose e lidhur dhe nuk ekziston ndonje detyrim, kontrate, mjet ose marreveshje qe mund te kete pasoja ose deme ne aktivitetin e shoqerise, mbi pronesite e saj apo ne ndonje veprim.

Shoqeria eshte pajisur me te gjithë licencat dhe lejet e tjera te nevojshme qe lejojne ushtrimin dhe administrimin e aktivitetit, te cilat aktualisht jane te vlefshme. Shitesi garanton se keto licenca apo leje nuk do te mbyllen, hiqen, apo te ndryshohen ne menyre te tille qe te sjellin pasoja mbi objektin per te cilin jane leshuar apo qellimit perse jane leshuar.

Bleresi deklaron dhe garanton Shitesin per sa me poshte;

- a. Bleresi ka fuqine e plote per te marre pjese si pale ne kete kontrate dhe te ekzekutoje detyrimet e marra persiper sipas kesaj kontrate. Bleresi ka ndermarre te gjithë veprimet e kerkuara per te perfunduar kete kontrate dhe per te ekzekutuar te gjithë detyrimin qe rrjedhin nga ajo.
- b. Zbatimi i kesaj kontrate nga pala Blerese nuk do te kete pasoja apo te cenoje ndonje dispozite, ligj, vendim apo urdher te zbatueshem per Bleresin.
- c. Bleresi zoteron te gjitha mjetet per te paguar cmimin e plote te kesaj kontrate.

NENI 7

PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE TË PALËVE

7.1. Kushtet për përmbushjen e detyrimeve nga ana e Shitësi.

Permbushja e detyrimeve të Shitesit që buron nga kjo kontratë dhe nga data e Transferimit do të zbatohen vetëm nëse:

- Deklarata dhe garancite e Blerësit të vendosura në këtë kontratë do të jenë të vërteta dhe korrekte në të gjithë aspektet që nga data e Transferimit, dhe në lidhje me këtë, Blerësi do të ketë realizuar të gjithë veprimet për qelimin e kësaj kontrate;
- Blerësi do të ketë ekzekutuar të gjithë detyrimin të parashikuar në këtë kontratë.

7.2. Kushtet për përmbushjen e detyrimeve nga ana e Blerësit.

Permbushja e detyrimeve të blerësit që burojnë nga kjo kontratë dhe nga data e Transferimit do të zbatohen vetëm nëse:

- Deklarata dhe garancite e Shitesit të vendosura në këtë kontratë do të jenë të vërteta dhe korrekte në të gjithë aspektet që nga data e Transferimit dhe në lidhje me këtë, Shitesit do të ketë realizuar të gjithë veprimet për qelimin e kësaj kontrate;
- Nuk ka asnjë veprim, proces apo procedim kundër Shitesit që mund të ndikojë në vlefshmerinë dhe legjitimitetin e detyrimeve dhe të akteve të miratuar sipas kësaj kontrate dhe që mund të shkaktojë dëm në zotesinë e Blerësit për të perfunduar dhe realizuar këtë kontratë;
- Shitesit duhet të ekzekutojë të gjithë detyrimin e parashikuar në këtë kontratë.

NENI 8 TRANSFERIMI I KUOTAVE

Me realizimin e kushteve dhe detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë, Shitesit do të humbasë pronësinë e tij respektivisht mbi 99.32 % të kuotave të zotëruara në kapitalin themeltar të shoqërisë PRI-INVEST sh.p.k dhe deklarojnë se me përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të përmendura, ata nuk do të kenë sot dhe në të ardhmen asnjë pretendim për pronësinë e këtyre kuotave. Ndërsa Blerësi do të bëhet pronar i i kuotës së transferuar, duke fituar çilesinë e ortakut të Shoqërisë.

Kapitali i Shoqërisë PRI-INVEST shpk, pas perfundimit të kontratës së shit - blerjes së kuotave, do të zotërohen si më poshtë:

- MARKETING & DISTRIBUTION LTD KOSOVË** e regjistruar me NIPT 80667051 me Ortakë të Vetme Znj. Vilma NUSHI zotëruese e 1 kuote, që përfaqëson 100% të kapitalit me vlerë prej 146,521,327 (njëqind e dyzet e gjashtë milion e pesëqind e njëzet e një mijë e treqind e njëzet e shtatë) Lekë .

NENI 9 ANULLIMI I KONTRATËS


Në rast se palët nuk do të ekzekutojnë dhe përmbushin detyrimet e tyre ashtu si përshkruhet në këtë kontratë, kjo kontratë do të bëhet e pavlefshme.

NENI 10
NDRYSHIMET, HEQJA DORE, ETJ.



Asnje dispozite e kesaj kontrate nuk mund te ndryshohet, te prishet apo te kufizohet, pervecse miratimit me shkrim te nenshkruar nga pala kundrejt te cilet behet ndryshimi, prishja apo kufizimi. Ne asnje rast, heqja dore nga ndonje prej kushteve të Kontrates nuk do te shtrihet apo te kete efekte tek ndonje tjetër kusht, ndaj te cilit nuk eshte hequr dore ne menyre te shprehur, dhe as do te demtoje ndonje te drejte qe preket nga doreheqja.

NENI 11
ZGJIDHJA E KONTRATËS



Kjo kontrate shitblerje kuotash do te konsiderohet e zgjidhur nese:

1. Nje nga palet do te deshtoje ne ekzekutimin e detyrimit te ndermarre ne perputhje me dispozitat e kesaj kontrate.
2. Nuk do te realizohet transferimi i kuotave ne daten e transferimit, si rezultat i veprimeve te paligjshme dhe mosveprimeve, ose neglizhences se ndonjeres prej paleve.
3. Nese vertetohet nje force madhore, lufte, revolucion apo shkaterrim i prones nga termeti, kur keto ngjarje kane ndodhur perpara Dates se Transferimit.

Nese kontrata do te zgjidhet per raste e parashikuara ne piken 1 dhe 2 te kontrates, pala qe ka shkaktuar demin do te jete pergjegjese dhe detyrohet te demshperbleje demet eventuale.

Nese kontrata do te zgjidhet per rastin e parashikuar ne piken 3 te kesaj dispozite, asnje nga palet nuk detyrohet te demshperbleje demet eventuale te shkaktuara.

NENI 12
TËRËSIA E KONTRATËS

Palet bien dakort dhe pranojne se te gjithë kushtet dhe dispozitat e kesaj kontrate jane themelore dhe te rendesishme. Ne perputhje me kontraten, secila nga palet kontraktuese i garanton dhe premtion pales tjetër, ekzekutimin e te gjithë detyrimeve me mirebesim dhe ne perputhje me te gjithë kushtet dhe dispozitat parashikuar ne te.

Per me teper, palet deklarojne se, ne ekzekutimin e kesaj kontrate, ata kane marre ne konsiderate ndonje apo gjithë ndryshimet e papritura te rrethanave.

Pervec kesaj, palet bien dakort te kryejne veprime te tjera dhe te ekzekutojne e te dorezojne dokumente te tjere nese eshte e nevojshme apo e pershtatshme per te arritur qellimin e kesaj kontrate.

NENI 13
LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

Kjo kontrate do te interpretohet ne përputhje me ligjet shqiptare dhe nëse ka ndonjë konflikt, qe nuk zgjidhet ne mënyre miqësore, konflikti do te zgjidhet përpara Gjykatës se Tiranës.

NENI 14

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Kjo kontrate hartohet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj kontrate, teksti në gjuhën shqipe do të ketë prioritet.

Kjo kontrate hartohet në 5 (pesë) kopje identike në shqip dhe anglisht, ku secila nga palët mban një kopje, një kopje depozitohet në Regjistrin Tregtar, një kopje do të depozitohet në Aktet e Shoqërisë.

Unë noteri, pasi verifikova identitetin e personave që u paraqitën para meje, si dhe zotësinë e tyre për të kuptuar dhe vepruar, si edhe të drejtat për të përfaqësuar palët e kësaj kontrate, lexoj më zë të lartë tekstin e kësaj kontrate, dhe palët dhe përfaqësuesit e tyre deklarojnë se e gjejnë tekstin e mësipërm në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe tagrat e deleguara.

Personat e paraqitur para meje nënshkruan këtë kontratë për llogari të palëve përkatëse duke firmosur si më poshtë, dhe unë noteri e vërtetoj atë në përputhje me ligjin.

PALËT

SHITËSI

MARKETING & DISTRIBUTION SH.P.K

Administrator

Z.Sokol VEHBI


.....


BLERËSI



MARKETING & DISTRIBUTION LTD
KOSOVË

Administrator

Z.Ermal RAMOSACO


.....


NOTER


.....




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË
DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR”**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L81423026D
2. Data e Regjistrimit	23/02/2018
3. Emri i Subjektit	Pri-Invest
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	12/02/2018
6. Kohëzgjatja	Nga: 12/02/2018
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Kashar KASHAR Autostrada Tirane-Durres, km 10, Kashar
8. Kapitali	146.521.327,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Objekt i veprimtarise se shoqerise do te jete kryerja e çdo aktiviteti tregtar te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrja ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, siç mund te ndryshohet here pas here dhe ne vecanti, por pa u kufizuar ne; Te zoteroje. te administroje. te bleje. te shes, te kembej dhe ne pergjithesi te tregtoj ose ndermjetesoj ne tregtimin e cdo pasurie te luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe ne lidhje me te drejtat mbi keto pasuri. Te kryej fdo biznes, pune ose veprimtari qe lidhet me cdo lloj pasuri te luajtshme ose te paluajtshme ne pergjithesite te ndertoje. menaxhoje, konstruktoje, ndryshoj. zmadhoje. riparoje. adaptoje. mobiloje cdo dyqan. magazine, zyra, apartamente. impiante. fabrika te cilat konsiderohen nga shoqeria si te nevojshme per qellimet e biznesit te saj. Te angazhohet ne shitje me shumice e pakice dhe te hape



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

dyqane, dege dhe zyra po te jete e nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise. Te angazhohet ne import eksport ne perputhje me qellimet e shoqerise. Gjithashtu, shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperm, cdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, si dhe cdo veprimtari me pasuri te luajtshme ose te paluajtshme qe mund te konsiderohet i nevojshem per ushrimin e veprimtarise sipas objektit te shoqerise. Per ushrim te aktivitetit te shoqerise me gjithe ndryshimet qe mund te kete shoqeria mund te hyje me marreveshje partneriteti dhe bashkepunimi me pale te trete qofshin ente publike apo private, te marre pjese ne procedura te ndryshme konkurrimi ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Te gjitha veprimtarite do te zhvillohen ne perputhje me ligjin qe rregullon ushrimin e asaj veprimtarie. Shoqeria do te marre te gjitha licencat dhe miratimet qe mund te jene te nevojshme per zhvillimin e veprimtarive te siperpermendura sipas kerkesave te ligjit te fushes.

10. Administratori/ët	Irena Mahilaj	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 12/02/2018	Deri: 12/02/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Marketing & Distribution	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 1.000.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	,68	
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Ortakët	MARKETING & DISTRIBUTION	
13.1 Vlera e kapitalit	Para:	Natyre: 145.521.327,00
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	99,32	
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: PRI-INVEST E-Mail: info@markdist.com Telefon: 0696621086
16. Statusi:	Aktiv

Lista e Dokumenteve:

Dokumenti i autorizimit

Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)

Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)

Akti i themelimit

Regjistrimi Fillestar: CN-671452-02-18



HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i te dhenave te regjistruara
15/11/2018	<p>Numri i ceshtjes: CN-007526-11-18</p> <p>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit, date 31.10.2018 ku eshte vendosur per zmadhimin e kapitalit dhe emerimi i Paqesor Qato, Ekspert Kontabel I Regjistruar per hartimin e raportit per zmadhimin e kapitalit te shoqerise. Depozitimi i Raportit per zmadhimin e kapitalit, date 06.11.2018. Depozitimi i vendimit, date 08.11.2018 ku eshte vendosur: Miratimi I raportit te zmadhimit te kapitalit te shoqerise.</p> <p><u>Vlera e Kapitalit ishte</u> "1.000.000,00" u be "146.521.327,00"</p> <p><u>Numri i Aksioneve ishte</u> "1,00" u be "2,00"</p> <p><u>Vlera e Aksionit ishte</u> "1.000.000,00" u be "73.260.663,50"</p> <p><u>E-Mail ishte</u> ("") u be ("info@markdist.com")</p> <p><u>Ownership Code ishte</u> ("E Huaj (100%)") u be ("E Përbashkët (shqiptare - e huaj)")</p> <p><u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek ortaket juridik:</u></p> <p><u>eshte shtuar ortaku:</u> ("MARKETING & DISTRIBUTION") Numri i aksioneve "1,00" Pergindja ne kapital "99,32" Kontributi ne natyre "145.521.327,00"</p> <p><u>Kane ndryshuar te dhenat per</u> ("Marketing & Distribution")</p> <p><u>Pergindja e Kapitalit ishte</u> ("100,00") u be ("68")</p> <p>Lista e Dokumenteve: Dokumenti i autorizimit</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



<p><u>Aplikim per garanci tjetër</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u> <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u> <u>Akti i ekspertimit te ekspertit vleresues te licensuar per pagesen e kapitalit ne natyre</u></p>

Datë: 04/01/2019

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Kopje nga

KONTRATË FINANÇIMI

Tiranë më 29.12.2014



FINANCUESI: Marketing & Distribution Sh.p.k Kosovë, regjistruar me vendim gjykate, me numër biznesi 80667051 me adresë rruga Zona Industriale, Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Administratori Z. Ermal Ramosaco, referuar këtu e më poshtë si "Financuesi".

PËRFITUESI I FINANÇIMIT: Marketing & Distribution Sh.p.k Shqipëri, një shoqëri me seli në adresën Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar, regjistruar në Regjistrin Tregtar me NIPT J72124001N, përfaqësuar nga Znj. Vilma NUSHI, me cilësinë e Administratores së Përgjithshme të shoqërisë, referuar këtu e më poshtë si "Përfituesi".

Me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, palët bien dakort të lidhin këtë Kontratë Financimi me përmbajtjen si më poshtë vijon:

NENI 1 OBJEKTI

1.1 Objekti i kësaj Kontrate është financimi i përfituesit të financimit Marketing & Distribution Sh.p.k Shqipëri nga ana e financuesit Marketing & Distribution Sh.p.k Kosovë. Vlera e financimit do të përdoret në shërbim të aktivitetit tregtar të përfituesit.

1.2 Lëvrimi i financimit do të kryhet në përputhje me Nenin 2 të kësaj Kontrate.

NENI 2 VLERA E FINANÇIMIT

2.1 Vlera e financimit në total do të jetë deri në 2,500,000 (dymilion e pesëqind mijë) Euro.

2.2 Çdo lëvrim i mëtejshëm në favor të Përfituesit të financimit që nuk është parashikuar, do të bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve, cila do të materializohet në një Aneks Kontratë që i bashkëlidhet kësaj Kontrate dhe që është pjesë integrale e saj.

NENI 3 MËNYRA E FINANÇIMIT

3.1 Financuesi do të depozitojë në llogarinë bankare të Përfituesit ose në arkën e tij, vlerat e financimit sipas Nenit 2 të kësaj Kontrate.

3.2 Depozitimi i financimit nga ana e Financuesit do të bëhet kundrejt kërkesës të Përfituesit të financimit.

NENI 4 AFATI

4.1 Kjo Kontratë financimi lidhet për një afat të pacaktuar. Ndërsa kthimi i financimit do të bëhet me kërkesën e parë të Financuesit.

NENI 5 TËD DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

5.1 Financuesi duhet të marrë përsipër të respektojë afatin dhe mënyrën e pagesës të parashikuar në këtë kontratë.

5.2 Përfituesi ka të drejtë të përdorë vlerën e depozituar vetëm për qëllime të financimit të aktivitetit ekonomik të shoqërisë.

5.3 Financuesi mund të kërkojë kthimin e një pjesë apo të gjithë vlerës së financimit duke njoftuar

Përfituesin 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara.

5.4 Përfituesi detyrohet që me kërkesë të Financuesit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, të kthejë një pjesë apo të gjithë vlerën e financimit.

5.5 Përfituesi detyrohet të ruajë konfidencialitetin e të dhënave të këtij financimi përveç rasteve kur është i detyruar sipas ligjeve të zbatueshme dhe akteve nënligjore.

NENI 6

PËRFUNDIMI I KONTRATËS

6.1 Kjo Kontratë mund të zgjidhet me vullnetin e palëve duke dhënë një njoftim paraprak prej një muaji dhe pasi palët kanë përmbushur detyrimet përkatëse të tyre.

6.2 Kontrata mund të zgjidhet edhe në rast se ndonjëra prej palëve nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë Kontratë. Në këtë rast, pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë dhe shpërblimin e dëmit.

NENI 7

LEGJISLACIONI DHE GJYKATA KOMPETENTE

Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe çdo mosmarrëveshje, keqkuptim ose pretendim që mund të lindë për këtë Kontratë ose në lidhje me të do të gjykohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 8

HYRJANË FUQI

Kjo Kontratë do të fillojë efektet juridike të saj, menjëherë me depozitimin e shumës së parë të financimit në Bankë.

Kjo Kontratë u hartua në 2 (dy) kopje të njëjta e të barasvlerëshme, në gjuhën shqipe.

Palët shprehen se kanë marrë dijeni të plotë për të gjitha efektet ligjore të saj, deklarojnë se çdo klauzolë e kësaj Kontrate është në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë dhe e nënshkruajnë atë.

PALËT

FINANCUESI
MARKETING & DISTRIBUTION SH.P.K
KOSOVË
E-mail: RAMOSACO



PËRFITUESI I FINANCIMIT

“Marketing & Distribution” SH.P.K.

Znj. Vilma NUSHI



Tiranë më datë 01.12.2016

Prot. 5011304187
26/08/2018

ANEKS KONTRATE FINANCIMI NR.01

(Lidhur me Kontratën e Financimit Prot.Nr. datë



FINANCUESI: MARKETING & DISTRIBUTION LTD KOSOVË e regjistruar me NIPT 80667051 me adresë rruga Zona Industriale, Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Administratori **Z. Ermal RAMOSACO**, në cilësinë e Përfaqësuesit Ligjorë të shoqërisë.

PËRFITUESI I FINANCIMIT: MARKETING & DISTRIBUTION sh.p.k, një shoqëri me seli në adresën Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar, regjistruar në Regjistrin Tregtar me NIPT J72124001N, përfaqësuar nga **Z. Sokol VEHBI**, me cilësinë e Administratores së Përgjithshme të shoqërisë.



Duke u bazuar në dispozitat e Kodit Civil si dhe në Kontratën e Financimit, Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Aneks Kontratë në lidhje me ndryshimin e vlerës së financimit dhe heqjen me kusht të normës së interesit të aplikuar, me të dhënat si më poshtë:

Neni 2 "Vlera e Financimit" ISHTE:

- Vlera e financimit në total do të jetë deri në 2,500,000 (dymilion e pesëqind mijë) Euro.

Neni 2 "Vlera e Financimit" BËHET:

- Vlera e financimit në total do të jetë deri në 4,000,000 (katërmilion) Euro.
- Burimi i financimit është financimi pa interes i Ortakut i Vetëm i shoqërisë Marketing & Distribution Sh.p.k Kosove dhe Marketing & Distribution Shqiperi, ne shoqerine Marketing & Distribution Sh.p.k.

Neni 2 Dispozita Përfundimtare

2.1 Kontrata e nënshkruar mes palëve, bashkë me këtë Aneks Kontratë, përmban marrëveshjen e plotë midis Palëve dhe nuk mund të modifikohet ose korrigjohet, përveç rasteve kur Palët bien dakort me shkrim.

2.2 Në përputhje me nenin 686 të Kodit Civil, Palët deklarojnë se i kanë lexuar, kuptuar dhe pranuar/miratuar nenet e kësaj Aneks Kontrate.

QFLE - Q357AS.01 040915

29
Façe
3a 19a 4
Façe 1

2.3 Kjo Aneks Kontrate ka vlerë të njëjtë me kontratën së cilës i referohet dhe hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin nga palët.

2.4 Të gjitha kushtet e tjera të kontratës mbetën të pa ndryshuara.



FINANCUESI
MARKETING & DISTRIBUTION
KOSOVE

PALËT

PËRFITUESI I FINANCIMIT
MARKETING & DISTRIBUTION SH.P.K

Ermal RAMOSI



Sokol VEHBI





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije-
Ministry of Trade and Industry

Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë / Kosovska Agencija za Registracije Biznisa /
Kosova Business Registration Agency

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION



80667051

(Nr. i biznesit / Br. biznisa / Business No.)

" Marketing & Distribution " SH.P.K.

Emri i biznesit / Naziv biznisa / Name of Business

Lloji i biznesit
BusinessType
Tip biznesa

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Limited liability company
Društvo sa ogranicenom odgovornošću

Adresa
Address
Adresa

Republika e Kosovës, Prishtinë, Prishtinë
Republic of Kosovo, Pristina, Pristina
Republika Kosova, Priština, Priština
Zona Industriale

Data e inkuorporimit
Date of incorporation
Datum inkuorporiranjë

29/12/2011

Data e regjistrimit
Date of registration
Datum registracije

17/07/2002

29/12/2011

Data/Date/Datum

Nenshkrinj/Signature/Potpis



Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Nr. Biznesit/Business No./Br. Biznisa
80667051

Aplikacioni/Application/Aplikacija

Subjekti i regjistrimit:
Registration subject
Subjekt registracije:

Data e plotësimit:
Filling date: 17/07/2002
Datum:

Date e pranimit:
Reception date:
Datum primljenje

Numri i protokollit:
Protocol number: 119012162
Broj protokola:



Biznesi/Business/Biznis

Tipi i biznesit:
Business type: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Limited liability company
Tipi biznisa:
Društvo sa ograničenom odgovornošću

Emri i biznesit:
Business name: "Marketing & Distribution" SH.P.K.
Naziv biznisa:

Adresa:
Address: Republika e Kosovës, Prishtinë, Prishtinë
Republic of Kosovo, Pristina, Pristina
Adresa: Republika Kosova, Prishtina, Prishtina
Zona Industriale

Data e konstituimit:
Constitution date: 29/12/2011
Datum konstituisanja:

Kapitali i përgjithshëm:
Total Capital: €760,000.00
Totalni kapital:

Numri i puntorëve:
Number of employees: 64
Broj radnika:

80667051

Veprimtaritë / Activities / Dejtnosti

4690

Primar

Tregtia me shumicë jo e specializuar
Non-specialised wholesale trade
Nespecializirana trgovina na veliko

4711

Sekondar

Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani
Retail sale in non-specialised stores with food, beverages or tobacco predominating
Trgovina na malo u nespecializiranim prodavaonicama pretežno hranom, pićima i duvanskim proizvodima

4646

Te Tjera

Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutikë
Wholesale of pharmaceutical goods
Trgovina na veliko farmaceutskim proizvodima

4729

Te Tjera

Tregtia me pakicë e produkteve të tjera ushqimore në dyqane të specializuara
Other retail sale of food in specialised stores
Ostala trgovina na malo prehrambenim proizvodima u specijaliziranim prodavnicama

4775

Te Tjera

Tregtia me pakicë e artikujve kozmetikë dhe të tualetit, në dyqane të specializuara
Retail sale of cosmetic and toilet articles in specialised stores
Trgovina na malo kozmetičkim i toaletnim proizvodima u specijaliziranim prodavnicama

4789

Te Tjera

Tregtia me pakicë në tezga dhe tregje të mallrave të tjera
Retail sale via stalls and markets of other goods
Trgovina na malo ostalom robom na štandovima i pijacama

4799

Te Tjera

Tregtia tjetër me pakicë, jo në dyqane, tezga ose tregje
Other retail sale not in stores, stalls or markets
Ostala maloprodaja ne u prodavnicama, tezge ili pijace

7711

Te Tjera

Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) i veturave dhe automjeteve të lehta motorike
Rental and leasing of cars and light motor vehicles
Iznajmljvanje i davanje u zakup (leasing) automobila i motornih vozila lake kategorije

7739

Te Tjera

Marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e makinerisë, pajisjeve dhe artikujve të tjerë të luajtshëm p.k.t.
Rental and leasing of other machinery, equipment and tangible goods n.e.c.
Iznajmljvanje i davanje u zakup (leasing) ostalih strojeva, opreme i materijalnih dobara, d. n.

7311

Te Tjera

Agjencitë për publicitet
Advertising agencies
Agencije za promociju (reklamu i propagandu)

4941



8066705



Pronarët / Owners / Vlasnici

Person fizik

Emri: Vilma
Name: Vilma
Ime: Nushi

ID Personale:
Personal ID: BC8802012
Licni ID:


Adresa: Shqipëria, Tiranë, Tiranë
Address: ALBANIA, Tiranë, Tiranë
Adresa: ALBANIA, Tiranë, Tiranë
Dedë Gjo Luli P 3/1

Përgjegjësia:
Liability: Përgjegjësi e kufizuar
Responsibility: Përgjegjësi e kufizuar

Pjesa në pronë:
Owned part: 760000
Deo o vlasnistvu:

Pjesa e paguar:
Paid Part: 760000
Placeni deo:

Data e lindjes:
Date of birth: 1961.06.30
Dan rodjenja:



80667051

Personat e autorizuar / Authorized participants / Ovlascene lice

Emri: Feti
Name: Beka
Ime:

ID Personale:
Personal ID: 1000936487
Licni ID:

Pozita e punës:
Job position: Agjent i Regjistruar
Radno mesto:

Adresa: Republika e Kosovës, Prishtinë, Prishtinë
Address: Republic of Kosovo, Pristina, Pristina
Adresa: Republika Kosova, Priština, Priština
Zona Industriale

Emri: Ermal
Name: Ramosaçaj
Ime:

ID Personale:
Personal ID: BJ5834448
Licni ID:

Pozita e punës:
Job position: Drejtor Ekzekutiv
Radno mesto:

Adresa: Shqipëria, Tiranë, Tiranë
Address: ALBANIA, Tiranë, Tiranë
Adresa: ALBANIA, Tiranë, Tiranë
Komuna e Parisit



MARKETING & DISTRIBUTION

Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Tirana, Albania
 Tel: +355 48 202 336, Fax: +355 48 202 407
 e-mail: info@markdist.com

Licensë nr. 3707010
 Nr. Identifikimi J72124001N



**VENDIM
 I ORTAKUT VETËM**

Sot më datë 21.12.2018, në selinë e shoqërisë "Marketing & Distribution" sh.p.k, me NIPT J72124001N, me seli në adresën Autostrada Tiranë-Durrës, km 10, Kasharë, Tiranë, Shqipëri, Ortaku i Vetëm i shoqërisë Znj. Vilma NUSHI vendosi mbi rendin e ditës si vijon:


1. Miratimi i shitjes nga Marketing & Distribution sh.p.k të 99.32 % të aksioneve të saj në shoqërinë Pri-Invest Sh.p.k person juridik, regjistruar në organet tatimore me NIPT L81423026D, me seli pranë Autostradës Tiranë-Durrës, km. 10, Kashar, Tiranë, përfaqësuar nga Administratorja e shoqërisë Znj.Irena MAHILAJ, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë.
2. Përcaktimi i përfaqësuesit të shoqërisë në procedurat e nënshkrimit dhe të lidhjes së kontratës së Shitshitjes së aksioneve si më sipër.
3. Autorizimi i personit që do të ndjek procedurën e nevojshme pranë Q.K.B për të pasqyruar ndryshimet e mësipërme.

Përsa i përket pikës së parë të rendit të ditës, mbështetur në interesat e shoqërisë, ortakut i vetëm ka bërë propozimin për shitjen e 99.32 % te aksioneve të Marketing & Distribution Sh.p.k në shoqërinë Pri Invest Sh.p.k. Shoqëria transferon në këtë mënyrë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga transferimi i pronësisë së aksioneve dhe në të njëjtën kohë humbet cilësinë e aksionerit të shoqërisë së mësipërme. Duke qënë se Marketing & Distribution sh.p.k Kosovë ka kryer një financimim ndaj shoqërisë Shitëse Marketing & Distribution sh.p.k ku burim financimi ka qënë financimi i Ortakut të Vetëm të shoqërisë Marketing & Distribution Sh.p.k Kosovë dhe Marketing & Distribution Shqipëri, palët bien dakord që vlera e shitblerjes sipas kontratës do të likujdohet nëpërmjet kompensimit mes vlerës së kontratës dhe vlerës së kthimit të financimit.

Në përfundim të mbledhjes dhe duke mos pasur asnjë pikë tjetër për të diskutuar dhe vendosur, Ortaku i Vetëm i shoqërisë, në mbështetje me aktet e themelimit dhe të legjislacionit tregtar në fuqi. në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Ortaku i vetëm i Shëqërisë;

VENDOSI:

1. Të miratojnë transferimin nëpërmjet shitjes të masës prej 99.32% të aksioneve të saj në shoqërinë Pri-Invest Sh.p.k. Kuotat do të transferohen në favor të shoqërisë Marketing & Distribution sh.p.k Kosovë dhe si çmim i këtij transaksioni shitblerje aksionesh do të jetë shuma 151,691,870 (njëqind e pesëdhjetë e një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë




tetëqind e shtatëdhjetë) Lekë. Shoqëria Marketing & Distribution sh.p.k pas realizimit të praktikës së shitjes së kuotave nuk do të jetë më ortakë e shoqërisë Pri-Invest Sh.p.k dhe humb të gjitha të drejtat si pasojë e transferimit të tyre.

Ngarkohet Z. Sokol VEHBI si përfaqësues në procedurat e nënshkrimit dhe të lidhjes së kontratës së shitjes së kuotave dhe regjistrimin e saj pranë QKB.

ORTAKU I VETËM

“Marketing & Distribution” SH.P.K.

Znj. Vilma NUSHI

.....








VENDIM
I ORTAKUT TË VETËM

Sot më datë 26/12/2018, në selinë e shoqërisë “Marketing & Distribution” sh.p.k Kosovë me numër biznesi 80667051, me seli në zonën Industriale, Prishtinë, Kosovë, Ortaku i Vetëm i shoqërisë Znj.Vilma NUSHI vendosi mbi rendin e ditës si vijon:

1. Miratimi i blerjes nga Marketing & Distribution sh.p.k Kosovë të 99.32 % të aksioneve të shoqërisë Marketing & Distribution Sh.p.k Shqipëri në shoqërinë Pri-Invest Sh.p.k person juridik, regjistruar në organet tatimore me NIPT L81423026D, me seli pranë Autostradës Tiranë-Durrës, km. 10, Kashar, Tiranë, përfaqësuar nga Administratorja e shoqërisë Znj.Irena MAHILAJ.
2. Përcaktimi i përfaqësuesit të shoqërisë në procedurat e nënshkrimit dhe të lidhjes së kontratës së shitblerjes së aksioneve si më sipër.
3. Autorizimi i personit që do të ndjek procedurën e nevojshme pranë Q.K.B për të pasqyruar ndryshimet e mësipërme.

Përsa i përket pikës së parë të rendit të ditës, mbështetur në interesat e shoqërisë, ortaku i vetëm ka bërë propozimin për blerjes e 99.32 % te aksioneve të Marketing & Distribution Sh.p.k Shqipëri në shoqërinë Pri-Invest Sh.p.k. Duke qënë se Marketing & Distribution sh.p.k Kosovë ka kryer një financim ndaj shoqërisë Shitëse Marketing & Distribution sh.p.k ku burim financimi ka qënë financimi i Ortakut të Vetëm të shoqërisë Marketing & Distribution Sh.p.k Kosovë dhe Marketing & Distribution Shqipëri, palët bien dakord që vlera e shitblerjes sipas kontratës do të likujdohet nëpërmjet kompensimit mes vlerës së kontratës dhe vlerës së kthimit të financimit.

Në përfundim të mbledhjes dhe duke mos pasur asnjë pikë tjetër për të diskutuar dhe vendosur, Ortaku i Vetëm i shoqërisë, në mbështetje me aktet e themelimit dhe të legjislacionit tregtar në fuqi. në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Ortaku i vetëm i Shoqërisë;

VENDOSI:

1. Të miratojnë transferimin nëpërmjet blerjes të masës prej 99.32% të aksioneve të shoqërisë Marketing & Distribution Sh.p.k Shqipëri në shoqërinë Pri-Invest Sh.p.k. Cmim i këtij transaksioni shitblerje aksionesh do të jetë shuma 151,691,870 (njëqind e pesëdhjetë e një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) Lekë. *Shoqëria Marketing & Distribution sh.p.k Kosovë pas realizimit të praktikës së shitjes së kuotave do të jetë Ortake e Vetme e shoqërisë Pri-Invest Sh.p.k me 100% te aksioneve dhe fiton të gjitha të drejtat si pasojë e këtij trasferimi.*
2. Caktohet Z. Ermal RAMOSACO, si përfaqësues me tagra të plota për të vepruar në emër të shoqërisë Marketing & Distribution Sh.p.k Kosovë për nënshkrimit dhe të lidhjen e kontratës së shitjes së kuotave dhe regjistrimin e saj pranë QKB.

ORTAKU I VETËM
“Marketing & Distribution” sh.p.k Kosovë

Znj. Vilma NUSHI

